

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS “HISTORI”**



Program orientues

**Koordinator:
Ines Todhe**

2025-2026

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar.....	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML.....	16
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	29
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	30
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.....	44
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular.....	52
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	54
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	64

HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në zhvillimin e individëve dhe në formimin e tyre si qytetarë të përgjegjshëm. Një mësues i mirë historie udhëheq dhe mentoron nxënësit të zbulojnë potencialet e tyre, të zhvillojnë aftësitë intelektuale, emocionale dhe të krijojnë marrëdhënie pozitive me mjedisin përreth duke nxitur tek ata ndjenjën e identitetit, e atdhedashurisë, e ndërgjegjësimit kulturor dhe qytetarisë.


Kompetencat e mësuesit të historisë shtrihen përtej transmetimit të thjeshtë të datave dhe të fakteve historike. Ai duhet të jetë i aftë të përdorë një sërë metodash inovative për të nxitur kuriozitetin e nxënësve dhe për ta bërë lëndën më të lehtë dhe më të kuptueshme. Mësuesit që përdorin teknika efektive mësimore, të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike. Npwmjet pwrdorimit të metodave dhe teknikave të larmishme ai i nxit nxënësit të analizojnë ngjarjet historike, të kuptojnë kontekstin e tyre, të pranojnë këndvështrimet e ndryshme, të dallojnë diferencën midis opinionit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, të vlerësojnë kontributet e kulturave të ndryshme, të respektojnë diversitetin shoqëror-kulturor, të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik dhe një ndjenjë të gjerë humanizmi.

Përdorimi i materialeve multimediale, si video, fotografi dhe dokumentarë, ndihmojnë për të ilustruar ngjarjet dhe personazhet historikë, duke i bërë ata më të prekshëm dhe më interesantë. Aktivitetet interaktive, si debatet, veprimtaritë, puna me burimet, simulimi i ngjarjeve historike dhe projektet, nxisin angazhimin aktiv dhe lejojnë nxënësit të eksplorojnë dhe të diskutojnë ide dhe perspektiva të ndryshme.

Në një botë në ndryshim të vazhdueshëm, rëndësia e mësuesve të historisë është më e madhe se kurrë, pasi ata përgatitin brezat e rinj për sfidat e së ardhmes dhe ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës



mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;

- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së historisë për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale etj.;
- të tregojë përgjegjëshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndergjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një domosdoshmëri në mësimdhënien me kompetenca bazuar dhe në modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e historisë për secilin nivel arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, dy modele orësh mësimore për lëndën e historisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektesh kurrikulare për lëndën e historisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të historisw;
- aspekte të pedagogjisë, të metodologjisë dhe të përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor të lëndës së historisw;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të historisw.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË HISTORISË”

Kompetenca	
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e rezultateve të nxënësve të programit;	• Korniza kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.

- siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i historisë:

- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;
- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;
- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;
- mbështet nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);
- planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;
- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së historisë;
- edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmërinë ndaj lëndës së historisë;
- motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë.

- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;
- punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e historisë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i historisë:

- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të nxwni të caktuar;
- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;
- planifikon veprimtari mwsimore qw nxisin ndwrtimin e kompetencave lwndore dhe kompetencave kyce;
- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;
- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;
- përdor kërkimin si pjesw e metodologjisë në mësimdhënien – nxënien e historisë;
- demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;
- zbaton parimet e hartimit të një testi për nxënësit.

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë.
- Udhëzuesi “Adresimi i antisemitizmit në shkollë”.
- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, Lënda: histori.
- Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP, Lënda: histori.

Kompetenca III	
“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> • prezanton ngjarje/çështje historike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word; • nxit nxënësit të bëjnë kërkime dhe prezantime duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website, si dhe prezantime në Power Point, Prezi ..	• Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së historisë që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie. • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP.

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. - Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca

“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së historisë”

Literatura e rekomanduar

Mësuesi i historisë:

- dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat VI-IX dhe X-XII;
- përshkruan konceptet historike për klasat VI-IX dhe X-XII;
- përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;
- dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;
- shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhave të ndryshme historike për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre, bazuar në burimet historike;
- shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike;
- Programe dhe tekste të lëndës së historisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX, për arsimin e mesëm të ulët dhe X – XII, për arsimin e mesëm të lartë.

- komunikon njohuritë historike në forma të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;
- ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- shpjegon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë, për ngjarje/çështje të ndryshme historike;
- përdor burimet historike për të shpjeguar arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike për periudha të ndryshme të historisë;
- dallon se si njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike, bazuar në burimet historike;
- vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme;
- interpreton efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- shpjegon vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- demonstroi aftësi të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;

- 
- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none">• shpjegon se lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës. | |
|--|--|

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Modele pyetjesh të lëndës “Histori”, AMU

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Procesi i përhapjes së protestantizmit në Evropën kontinentale trajtohen në programin:

- A) Historia 6
- B) Historia 9
- C) Historia 7
- D) Historia 8

Pyetja 2

Mësuesi u drejton nxënësve një pyetje të tillë: “Vlerësoni figurën e”. Kjo pyetje i takon nivelit të:

- A) Njohjes dhe vlerësimit
- B) Analizës dhe kuptuarit
- C) Njohjes dhe zbatimit
- D) Sintezës dhe vlerësimit

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetje 3

Qarkoni alternativën e saktë. Diagrami i Venit është një teknikë që e nxit nxënësin:

- A) të evidentojë të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve;
- B) të mendojë dhe parashikojë rreth asaj që lexon;
- C) të mendojë për të krijuar lidhje midis fakteve;
- D) të shfaq mendimet dhe idetë e tij.

Pyetje 4

Në cilin prej tematikave të mëposhtëm zhvillohet “Republika e Vajmarit”?

- A) Vendet e Ballkanit dhe kontinentet e tjera në vitet 1918 – 1939.
- B) Diktaturat, totalitarizmi komunist dhe ai fashist.
- C) Lufta e Dytë Botërore, ndarja e botës në dy blloqe.
- D) Demokracitë perëndimore në vitet 1918 – 1938.

Pyetja 5

Qarkoni alternativën e saktë. Gjatë planifikimit të testit hapi parë që duhet të kryejë mësuesi është

- A) lloji i pyetjes;
- B) gjatesia e testit;
- C) specifikimet e testit;
- D) rezultatet e synuara të nxënësit.

Pyetja 6

Qarkoni alternativën e saktë. Të nxënësit me situata NUK i mundëson nxënësit të mësojnë nëpërmjet:

- A) Socializimit
- B) Reflektimit
- C) Vizualizimit
- D) Riprodhimit

Pyetja 7

Qarko alternativën e saktë: Komenti i mësuesit për të vlerësuar dhe gjykuar komentet e nxënësve është pjesë e metodës:

- A) Ditari dypjesësh
- B) Organizuesi grafik i analogjisë
- C) Di-Dua të di- Mësova
- D) Brainstorming

Pyetja 8

Cila nga llojet e mëposhtme të pyetjeve bën pjesë në pyetjet objektive?

- A) Pyetjet e strukturuara
- B) Pyetjet me fund të hapur
- C) Pyetjet ese
- D) Pyetjet me alternativa

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Mësuesi/ja ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi/ja, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucijon arsimor

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Fisi ilir i enkelejdëve shtrihej në:

- A) territorin e Kosovës së sotme;
- B) territorin midis luginave të Semanit dhe Matit;
- C) zonën rreth Durrësit dhe Krujës;
- D) zonën rreth liqenit të Ohrit dhe të Prespës.

Pyetja 14

Kuvendi themelues i Lidhjes së princërve shqiptarë u mbajt në Lezhë sepse:

- A) Lezha kishte terren të thyer malor;
- B) Lezha gjendej në një zonë strategjike;
- C) në këtë mënyrë i bëhej një ftesë për bashkëpunim Venedikut;
- D) Zoti i Lezhës ishte përkrahësi kryesor i Skënderbeut.

Pyetja 15

Kongresi i Vjenës me vendimet e tij, siguroi:

- A) zgjerimin territorial të Francës;
- B) promovimin e institucioneve demokratike;
- C) një periudhë të gjatë qetësie për Evropën;
- D) vendosjen e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare.

Pyetja 16

Qëllimi kryesor i politikave ekonomike të ndjekura nga Stalini, ishte të:

- A) thithte investime të huaja;
- B) zhvillonte më shumë industrinë e rëndë;
- C) prodhonte me bollëk mallra konsumi;
- D) ndihmonte financiarisht të varfrit për të rritur prodhimin bujqësor.

Pyetja 17

Ligjet e Nurembergut lidheshin me:

- A) ndalimin e lirisë së shtypit;
- B) ndryshimin e formës së regjimit;
- C) mohimin e të drejtave të hebrenjve;
- D) eliminimin e veprimtarisë së partive politike.

Pyetja 18

Statuti i Lushnjës përcaktonte si formë të organizimit shtetëror:

- A) Monarkinë absolute;
- B) Monarkinë kushtetuese;
- C) Republikën Presidenciale;
- D) Republikën Parlamentare.

Pyetja 19

“Faktet provojnë se shumë abuzime ndodhën me urdhër të Stalinit, pa marrë parasysh normat e partisë dhe ligjshmërisë sovjetike. Stalini ishte një njeri shumë dyshues... . Kur Stalini thoshte që dikush duhet të arrestohet, ishte e domosdoshme që të besohej që ai person ishte një “armik i popullit”. Bazuar në pasazhin e mësipërm, cili nga udhëheqësit e BRSS mbajti një qëndrim kritik ndaj figurës së Stalinit?

- A) Nikita Hrushov.
- B) Leonid Brezhnjev.
- C) Juri Andropov.
- D) Konstatin Çernjenko.

Pyetja 20

Vendimet e Traktatit të Shën Stefanit nuk u pranuan nga Fuqitë e Mëdha për shkak:

- A) se pjesa më e madhe e Shqipërisë i kalonte Serbisë;
- B) se zgjerohej shumë territori i Perandorisë Osmane;
- C) të krijimit të një Bullgarie shumë të madhe;
- D) të daljes në Adriatik të Turqisë.

Pyetja 21

Prilli i vitit 2009 shënon një nga momentet më të rëndësishme të Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist. Për cilën ngjarje bëhet fjalë?

- A) Anëtarësimi në Paktin e Stabilitetit.
- B) Marrja e statusit kandidat për BE.
- C) Anëtarësimi në NATO.
- D) Liberalizimi i vizave.

Pyetja 22

Reformacioni kishte si qëllim:

- A) Përhapjen e krishterimit në të gjithë botën
- B) Forcimin e pozitave të kishës katolike
- C) Reformimin e kishës katolike
- D) Reformimin e kishës anglikane

Modele pyetjesh në lëndën “Histori”, AML

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin parauniversitar rrjedh nga:

- A) Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar.
- B) Korniza e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.
- C) Korniza e vlerësimit të cilësisë së shkollës.
- D) Korniza konceptuale e programit.

Pyetja 2

Qarkoni alternativën e saktë. Cilës prej tematikave të mëposhtme i takon “Traktati i Fshehtë i Londrës”, në historinë e klasës së 11-të?

- A) Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912 – 1939.
- B) Shqiptarët në fund të shekullit XIV deri në fillimin e shekullit XX.
- C) Shqiptarët dhe lufta e dytë botërore 1939 – 1944.
- D) Shqipëria gjatë regjimit komunist 1944 – 1990.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetja 3

Qarkoni alternativën e saktë. Në cilin grup të metodave të mësimdhënies bën pjesë ekskursioni?

- A) Metodatat e punës në grup.
- B) Metodatat e hulumtimit.
- C) Metodatat e mendimit kritik.
- D) Metodatat e mendimit krijues.

Pyetja 4

Qarkoni alternativën e saktë. Cilët prej niveleve të arritjeve i përket vlerësimi me notën 7-të?

- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

Pyetja 5

Qarkoni përgjigjen e saktë. Nxënësit arrijnë të nxënë 70% të rezultateve të të nxënës në klasë nëse:

- A) lexojnë tekstin.
- B) marrin pjesë në diskutime.
- C) shikojnë një demonstrim
- D) dëgjojnë me vëmendje mësuesin

Pyetja 6

Një mësues orientoi nxënësit të përdornin teknikën “Hulumtimi” gjatë zhvillimit të një projekti kurrikular. Një nga hapat më poshtë që përdoren për kryerjen e hulumtimeve dhe marrjen e rezultateve të mira NUK është pjesë e kësaj teknike.

- A) Përcaktimi i pyetjes

- B) Të shkruarit e pyetjes
- C) Organizimi i infomacionit
- D) Prezantimi i informacionit**

Pyetja 7

Lënda e historisë zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh kyçe, të cilat mbështesin studimin e historisë. Në alternativat e mëposhtme qarkoni kompetencën historike.

- A) Ndryshimi dhe vazhdimësia
- B) Analiza shkak-pasojë
- C) Kuptimi kronologjik
- D) Rëndësia historike**

Pyetja 8

Cili nga rezultatet e mëposhtme të të nxënit që realizohet nëpërmjet lëndës së historisë NUK i përket kompetencës digjitale?

- A) Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike.
- B) Komunikon, prezanton dhe parashtroon njohuritë historike.
- C) Zhvillon kompetencën digjitale për të gjetur, për të analizuar, për të komunikuar informacionin historik.
- D) Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme fetare.**

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.**

Pyetja 10

Procesi i gjithëpërfshirjes fillon me:

- A) nxitjen e diferencave mes nxënësve.
- B) njohjen dhe pranimin e diferencave mes nxënësve.
- C) zhvillimin e të drejtave të nxënësve.
- D) thellimin e diferencave mes nxënësve.

Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- E) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- F) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- G) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të Ministrit.
- H) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me Udhëzim të Ministrit

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Portofoli professional i mësuesit
- B) Portofoli profesjonal i mësuesit
- C) Portofoli profesional i mësuesit
- D) Portofoli profesijonal i mësuesit

Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Një nga pasojat e përfundimit të Luftës 100 vjeçare mes Anglisë dhe Francës solli:

- A) fitoren e Francës dhe përqendrimin e plotë të pushtetit republikan;
- B) fitoren e Francës dhe përqendrimin e plotë të pushtetit monarkik;
- C) fitoren e Anglisë dhe shpalljen e saj monarki parlamentare;
- D) fitoren e Anglisë dhe shpalljen e saj monarki absolute.

Pyetja 14

Cila prej ideve të mëposhtme i përket iluministit Zhan Zhak Ruso?

- A) Kritika e klerikalizmit dogmatik.
- B) Vendosja e formës republikane të qeverisjes.
- C) Qeverisja e kufizuar në raport me të drejtat e njeriut.
- D) Ndarja dhe pavarësia e pushteteve brenda një shteti.

Pyetja 15

Ishte pasojë e drejtpërdrejtë e Reformacionit:

- A) Lufta 30-vjeçare;
- B) Skizma e Madhe;
- C) Lufta e Madhe fshatare në Gjermani;
- D) Ndryshimi i hartës fetare të Evropës.

Pyetja 16

Federalizmi ishte një nga parimet e:


- A) Deklaratës së Pavarësisë;
- B) Artikujve të Konfederatës;
- C) Kushtetutës amerikane të vitit 1787;
- D) Politikës angleze në Amerikën e Veriut.

Pyetja 17

Përdorni informacionin e mëposhtëm për t'iu përgjigjur pyetjes.

“Miq të mi të mirë, për herë të dytë në historinë tonë, një kryeministër britanik është kthyer nga Gjermania duke sjellë paqe me nder. Unë besoj se kjo është paqja e kohës sonë... . Shkoni në shtëpi dhe flini të qetë.”

Neville Chamberlain, (Deklaratë pas kthimit të tij nga Konferenca e Mynihut.)



Bazuar në deklaratën e mësipërme, cila prej politikave të mëposhtme do të parandalonte një luftë të re?

- A) Politika e izolimit.
- B) Politika e lëshimeve.
- C) Politika e kundërpërgjigjes.
- D) Politika e dëmshpërblimeve.

Pyetja 18

Holokausti ishte keqtrajtimi dhe shfarosja gjatë Luftës së Dytë Botërore e:

- A) Romëve;
- B) Hebrenjve;
- C) Ushtarëve italianë;
- D) Dezertorëve të luftës.

Pyetja 19


Cili prej pohimeve të mëposhtme ishte shkak për kolapsin ekonomik të sistemit komunist në Shqipëri?

- A) Rritja e iniciativës ekonomike private në vitet '80.
- B) Rritje e eksporteve të produkteve shqiptare.
- C) Racionimi i ushqimit nëpërmjet tollonave.
- D) Administrimi i centralizuar i ekonomisë.

Pyetja 20

Një nga karakteristikat e ekonomisë gjatë sistemit komunist në Shqipëri ishte:

- A) privatizimi i ndërmarrjeve me kapital vendas;
- B) zbatimi i ekonomisë së tregut të lirë;
- C) privatizimi i ndërmarrjeve të huaja;
- D) eliminimi i pronës private.



Pyetja 21

Hartimi i Kodit Penal, Civil dhe Tregtar me standarde evropiane u bë gjatë viteve të:

- A) Qeverisë së Sulejman Delvinës (1920);
- B) Qeverisë së Fan Nolit (1924);
- C) Republikës Shqiptare (1925-1928);
- D) Monarkisë Shqiptare (1928-1939).

Pyetja 22

Në janar të vitit 1916, Kosova dhe viset e tjera në Maqedoni dhe në Mal të Zi u pushtuan nga trupat bullgare dhe austro-hungareze. Në zonën bullgare të pushtimit u vendos pushteti ushtarak që diktohej nga gjendja e luftës. Komanda ushtarake bullgare:

- A) Hapi shkollat shqipe ku të gjitha lëndët mësoheshin në gjuhën shqipe.
- B) Mbështeti dëshirat e shqiptarëve në fushën e arsimit dhe kulturës.
- C) Mohoi të drejtat kombëtare të shqiptarëve, i keqtrajtoi, i burgosi dhe i internoi ata.
- D) Ligjëroi përdorimin e flamurit shqiptar dhe gjuhës shqipe në administratë.

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përse i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënës dhe përshtaten me stilet e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxëni efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënës që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur dy modele orësh mësimore për lëndën e historisë në nivelet arsimore AMU dhe AML, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënit, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

Model ore mësimore në lëndën e “Historisë”AMU

Model ore mësimore në lëndën e historisë në AMU			
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: IV	Klasa: 9
Tema mësimore: Kosova dhe Çamëria gjatë Luftës së Dytë Botërore		Situata e të nxënit: Lexohet thirrja e përbashkët e KQ të Partisë Komuniste Shqiptare dhe Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit. <i>“Në këtë luftë çlirimtare, ku luhet fati i popujve, duhet që dhe ne të marrim pjesë me armë në dorë për të shpëtuar njëherë e mirë prej robërisë. Prandaj ta lidhni luftën tuaj me atë të vëllezërve tuaj në Shqipëri, si dhe me luftën e vendeve fqinj të Malit të Zi, Serbisë e të Greqisë. Formoni çetat tuaja partizane dhe bashkëpunoni me ato të partizanëve jugosllavë. Formoni sa më parë frontin e përbashkët me të gjithë popujt kundër armiqve të përbashkët, pasi kjo është rruga e vetme për të fituar lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes”.</i> (Marrë nga Historia e popullit shqiptar, vëllimi 4, f. 133) Pas leximit mësuesi ju kërkon nxënësve tu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:	

	• Si e kuptoni këtë thirrje? • Përse shërbente kjo thirrje e përbashkët? • Cilët janë popujt që përfitojnë nga krijimi i frontit të përbashkët kundër pushtuesit?
Rezultatet e të nxënësve: Nxënësi/-ja: • Përshkruan administrimin e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore; • Analizon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore; • Vlerëson qëndresën e popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve;	Fjalë kyçe: Zonë pushtimi, e drejtë kombëtare, Lidhja e Dytë e Prizrenit, parimi i vetëvendosjes Konferenca e Bujanit.
Burimet :“Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945”, autor Dr. Haxhi Ademi, linku: https://ih-rks.org/kosova-gjate-luftes-se-dyte-boterore-1941-1945/ ; Monografia me titull “Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore” me autor Dr.Lorenc Agalliu, linkun: https://unitir.edu.al/ceshtja-came-gjate-luftes-se-dyte-boterore-2/ Fotografi dhe ilustrime.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Gjuhët dhe komunikimi • Qytetari • Gjeografi • TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve janë përzgjedhur duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrimi.	

FAZAT	STRATEGJITË	VEPRIMTARITË E NX.	ORGANIZIMI I NX.
P	Parashikimi me terma paraprakë	Nxitja e diskutimit	Punë çifte dhe me githë klasën
N	Lojë me role	Ndërtimi i kompetencave historike dhe kyçe	Punë në grupe
P	Diagrama e Venit Pyetje- Përgjigje	Paraqitja grafike	Punë në dyshe

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (parashikimi me terma paraprakë)

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat dhe vitet: Kosovë, pushtues, Çamëri, Lufta e Dytë Botërore, qëndresë, viti 1941, 1942, 1943, 1944.

- Nxënësit, në çift të shkruajnë nga një fjali me këto terma dhe i vendosin në linjën e kohës sipas viteve.
- Linja e kohës dhe fjalitë e ndërtuara vendosen të gjitha në tabelë dhe lexohen nga mësuesi.
- Nxënësit pyesin për informacionin e panjohur ose për ta saktësuar atë.

Ndërtimi i njohurive të reja- klasa organizohet në grupe, metoda është Loja me role

Mësuesi/ja për të ndarë klasën në grupe përdor muajin e lindjes së tyre, duke i kërkuar të ngrihen në këmbë, të rreshtohen njëri pas tjetrit, sipas muajit në të cilin kanë lindur dhe i ndan në 6 grupe.

Mësuesja ndan 5 fisha për rolet që do të këtë çdo nxënës i grupit dhe së bashku me to edhe informacionet e detyrat për çdo grup:



Udhëheqësi

Shpërndan informacionin dhe është përgjegjës për të siguruar që detyrat të kryhen në kohën e caktuar.

Inkurajuesi

Siguron që të gjithë të marrin pjesë në diskutim dhe mendimet e të gjithëve të dëgohen.

Raportuesi

Raporton për rezultatet e punës së grupit dhe nëse është e nevojshme komunikon me mësuesin.

Mendja krijuese

Inkurajon të menduarit krijues dhe paraqet perspektiva befasuese.

Vlerësuesi

Siguron që grupi të vlerësojë atë që ka bërë, atë që ka mësuar dhe mendon se si mund të përmirësohet puna.

Mësuesi/ja ka marrë materialet nga botimet dhe ia shpërndan nxënësve ose orienton nxënësit të përzgjedhin dhe shqyrtojnë informacionin nga interneti:

1. **“Kosova gjatë luftës së dytë botërore 1941-1945”**, autor Dr. Haxhi Ademi ose duke klikuar mbi linkun: <https://ih-rks.org/kosova-gjate-luftes-se-dyte-boterore-1941-1945/>;
2. Monografia me titull **“Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore”** me autor Dr.Lorenc Agalliu ose duke klikuar në linkun: <https://unitir.edu.al/ceshtja-came-gjate-luftes-se-dyte-boterore-2/>

Detyrat për secilin grup janë:

Gr.1: Përshkruani organizimin administrativ të Kosovës;

Gr.2: Evidento pasojat e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë;

Gr.3: Si dhe pse populli i Kosovës bëri qëndresë ndaj pushtuesit?

Gr.4: Pse u organizua Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe cilat janë vendimet e saj?

Gr.5: Kur dhe pse u mbajt Konferenca e Bujanit dhe cilat janë vendimet e saj?

Gr.6: Përshkruaj veçoritë e qëndresës e shqiptarëve të Greqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.


Nxënësit, sipas roleve që i janë caktuar kontribuojnë në përfundimin e punës në grup. Pasi përfundon puna, çdo grup vendos punën e tij në një faqe muri të klasës dhe e prezantojnë atë përpara grupeve të tjera. Pas çdo prezantimi nxënësit vlerësojnë punën e bërë nga çdo grup dhe duartrokin.

Reflektimi

Metoda Diagrami i Venit

- Mësuesi/ja ndan nxënësit në çifte dhe kërkon nga ata të ndërtojnë në fletë A4 ose fletore skemën e diagramit të venit. Nxënësit plotësojnë skemën sipas modelit të mëposhtëm.

Diagrami i Venit



Veçoritë dalluese
Kosova: 1. 2. 3. Çamëria: 1. 2. 3.

Të përbashkëtat
Kosova dhe Çamëria: 1. 2. 3..

Lexohen përgjigjet dhe mësuesi/ja sqaron apo shpjegon konceptet apo informacionin e paqartë.

Pyetje-përgjigje

- Ku qëndron dallimi ndërmjet Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe Konferencës së Bujanit?
- Pse udhëheqja komuniste jugosllave u shpreh për mospranimin e rezolutës së Konferencës së Bujanit?
- Cilat janë parimet mbi të cilat duhej të ngrihej rezistenca e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi?
- Jepni gjykimin tuaj mbi përparësitë dhe mangësitë e këtyre parimeve.

Vlerësimi (*vlerësohen nxënësit për kërkimin historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe prezantimin bazuar në argumentet që japin, kontributin në punën në grup dhe punën me hartën, përdorimin e TIK*)

Vlerësimi i nxënësve sipas niveleve të arritjes

Niveli 2:

- Përshkruan me ndihmën e mësuesit ndonjë nga treguesit e administrimit të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Identifikon ndonjë nga shkaqet e qëndresës së shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Tregon ndonjë nga vlerat e qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

Niveli 3:

- Përshkruan disa nga treguesit të administrimit të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Analizon disa nga treguesit e qëndrimit të shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Vlerëson disa tregues të qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

Niveli 4:

- Përshkruan administrimin e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Analizon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;

- Vlerëson qëndresën e popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Zgjidhni një nga detyrat e mëposhtme dhe prezantoheni në PowerPoint ose Word:

1. Ese për qëndresën e popullit të Kosovës dhe të Çamërisë në Luftën e Dytë Botërore.
2. Informacion për qëndresën e shqiptarëve të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore.
3. Informacion kontributin e dhënë nga popullsia çame gjatë Luftës së Dytë Botërore.
4. Album me fotografi me momente të qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Model ore mësimore në lëndën e “Historisë” AML

Model ore mësimore në lëndën e historisë në AML			
Shkalla: IV	Lënda: Histori	Shkalla: 5	Klasa: 10
Tema mësimore Revolucioni Amerikan. Kushtetuta (45 minuta)		Situata e të nxënit: SHBA çdo 4 korrik feston Ditën Kombëtare të Shteteve të Bashkuara me fishekzjarrë, parada karnavale, panairë, piknik, festim familjar. Përgjigjuni pyetjeve: • Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë? • Çfarë ju kujton T. Xheferson? • Po Abraham Linkoln?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive Angleze të Amerikës së Veriut. 2. Analizon shkaqet e luftës civile dhe rrjedhojat e saj 3. Vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë dhe rolin e Kushtetutës amerikane në qytetërimin botëror.		Fjalët kyç: Deklarata e Pavarësisë, abolicionistë, luftë civile, merkantilizëm, konfederatë, koloni, bojkot, lëvizje federaliste, fuqi supreme, forca unioniste, ndarje pushtetesh.	
Burimet: Histori 10, Interneti. Wikipedia sq.m.wikipedia.org Mjetet: Foto e figurave të Revolucionit Amerikan Deklaratës së Pavarësisë, harta e Amerikës, video projektor.		Lidhja me fushat e tjera të të nxënit: • Gjuha dhe komunikimi, TIK-u, Gjeografia, Qytetaria Lidhja me temat ndërkurikulare:	

	• Respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
--	--

Organizimi i orës së mësimi:

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve janë përzgjedhur duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrimi.

Fazat	Strategjitë	Veprimtaritë e nxënësve	Organizimi i nxënësve
P	Stuhi mendimesh	Nxitja e diskutimit	Punë me gjithë klasën
N	Harta e konceptit	Ndërtimi i kompetencave historike dhe kyçe	Punë në grupe
P	Diagrami i Venit	Paraqitja grafike	Punë në dyshe

Parashikimi

Mësuesi/ja nëpërmjet pyetjeve më poshtë sjell në vëmendje të nxënësve njohuritë e mëparshme nëpërmjet lidhjes me revolucionin Anglez.

Mësuesi/ja pyet:

- Si u kufizua pushteti i mbretit në Angli?
- Cili ishte ndryshimi midis revolucionit dhe revolucionit të lavdishëm?
- Çfarë qeverisje pati Anglia pas revolucionit?
- Cili qe karakteri i Aktit të të Drejtave të Njeriut?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pyetjet e mësipërme.

Brainstorming:

Nxënësit shikojnë një dokumentar në lidhje me shpalljen e Pavarësisë së SHBA <https://youtu.be/cdVJij8EdPg>, pasi shikohet dokumentari diskutohet situata e të nxënësve dhe nxiten nxënësit tu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë?
- Çfarë ju kujton T. Xheferson?
- Po Abraham Linkoln?

- Nxirrni një fakt dhe një opinion nga video që patë.

Veprimtari: Ndërtimi i fjalorit. Përcaktoni termat e mëposhtëm bazuar në të kuptuarit e kontekstit historik. Nxënësit plotësojnë tabelën më poshtë në çift duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrim.

Terma	Përkufizimi
• Luftë Civile • Shtete të Unionit • Konfederatë • Abolicionistë • Koloni	

Ndërtimi i njohurive

Realizohet njohja e nxënësve me kompetencat e orës

Më pas nxënësit sistemojnë njohuritë:



Veprimtaria: Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe (teknika me numerim 1,2,3,4,5) duke i udhëzuar ata të lexojnë çështjet mësimore.

Grupi 1: Shkaqet e luftës për pavarësi

1. Koloni britanike
2. Nuk përfaqësoheshin në parlament
3. Vareshin nga sistemi merkantilist britanik
4. Rritja e taksave për shkak të luftës 7-vjecare me Francën

Grupi 2: Zhvillimi i luftës:

Masaçustesi qendra e luftës antibritanike

Filadelfia: Kongresi i parë Kontinental vendosi:

zhvillimin e protestave, krijimin e komisioneve për bojkot dhe mbledhjen e Kongresit të dytë.

Kongresi 2 maj 1775 udhëzoi T. Xheferson të hartonte Deklaratën e Pavarësisë 4 korrik 1776 shkëputja nga B.M


Grupi 3: Kushtetuta:

1787 Konventa miratoi Kushtetutën:

SHBA shtet federal

ndarja e pushteteve: legjislativ (kongresi) ekzekutiv (presidenti) gjyqësor (gjykatat federale)

Grupi 4: Lufta civile:



Grupi 5:

Shkaqet e luftës civile. Duke pasur parasysh arsyet pas shpërthimit të Luftës Civile, zgjidhni dy prej shkaqeve që ju i konsideroni si çështja më urgjente që shkaktoi këtë ngjarje. Citoni fakte historike për të mbështetur përgjigjen tuaj.

1

2

Nxënësit sipas grupeve pasqyrojnë momentet kyçe që ata kanë nxjerrë nga leximi. Më pas kalohet në diskutimin e këtyre çështjeve.

Ndërtimi i shprehive studimore.

Në përfundim mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të vazhdojnë punën me plotësimin e Diagramin e Venit

Veprimtari: Diagramin e Venit

Nxënësit nxjerrin të përbashkëtat e të veçantat e Revolucionit Anglez dhe Amerikan

Revolucionit Anglez	Të përbashkëtat	Revolucionit Amerikan
1.		1.
2.		2.

3.		3.
4.		4.

Pyetje

Pas plotësimit të tabelës mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Ku qëndron rëndësia e miratimit të Deklaratës së Pavarësisë?
- Pse themi që SHBA merret si shembulli i demokracisë në botë?
- Cilat qenë efektet e Luftës Civile?

Vlerësimi (*vlerësohen nxënësit për kërkimin historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe prezantimin bazuar në argumentet që japin, kontributin në punën në grup dhe punën me hartën, përdorimin e TIK))*)

Vlerësohet në nivelin N2:

Nxënësi që përcakton shkaqet e luftës për Pavarësi dhe vendimet e Kongresit I Kontinental

Vlerësohet në nivelin N3:


Nxënësi që analizon shkaqet, zhvillimin e pasojat e Luftës Civile?

Vlerësohet në nivelin N4:

Nxënësi që vlerëson përmbajtjen e Deklarata e Pavarësisë, Kushtetutës Amerikane dhe rolin e tyre në demokracinë botërore

Detyra dhe puna e pavarur. Linja e kohës

Nxënësi përcakton në linjën e kohës ngjarjet më të rëndësishme historike që çuan në shpërthimin e luftës civile deri në përfundim të saj.



Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës	0 pikë <i>Mësuesi nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe</i>	1 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen</i>	2 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e</i>	3 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës cilën e ka përdorur si pjesë të metodologjisë së mësimdhënies, ka</i>

	<i>mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.</i>	<i>e rezultateve të të nxënit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk është i lidhur me stilet e të nxënit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>nxënësve. Metodatat dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënit dhe me stilet e të nxënit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë zhvillimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyç të të nxënit</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të</i>

		<i>gjatë gjithë jetës.</i>	<i>kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>
--	--	----------------------------	---	--

Mjedisi i të nxënit (6 pikë)

Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimi për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë përfshihen dhe ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, ku nxënësit përfshihen në veprimtaritë mësimore, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë	<i>Mësuesi organizon orën e mësimi në mënyrë</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimi në mënyrë</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke u kujdesur që të</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke u kujdesur që të gjithë nxënësit</i>

nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm Shumë pak nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ai ose ata drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të pyesin apo të marrin një përgjigje për pyetjen e bërë.</i>	<i>gjithë nxënësit të përfshihen dhe të angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>të përfshihen dhe të angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
--	---	--	--	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumë llojshmëri të metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik</i>
---	--	--	---	---

mendimin ndryshe.	<i>Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>dhe krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</i>

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.	Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit.	Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.	Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.
	Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmirësimin e rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.	Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.	Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.	Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në

				rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjetet mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjetet mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e</i>

aftësitë digjitale të nxënësve	<i>rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	<i>përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimine TIK.</i>	<i>veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK- ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>
---	--	---	--	--

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme



nga puna e secilit nxënës.

- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AMU

Tema: Rilindja Shqiptare, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekujve XIX dhe fillimit të shekullit XX

Kohëzgjatja: 6 orë mësimore, (të planifikuara 2 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa: 7

Rezultatet e të nxënësit:

Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi

- harton, shtron pyetje për të shqyrtuar, për të analizuar veprimtaritë e Rilindësve Shqiptare për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare;
- shfrytëzon burimet dhe të dhënat historike për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve “Rilindje Shqiptare”, “Ndërgjegje kombëtare”;
- ndërlidh temën e projektit me njohuritë për periudhën e Rilindjes Europiane dhe ndikimin e saj tek elita intelektuale shqiptare;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në burime;
- vlerëson ndikimin e iluminizmit në Rilindjen shqiptare;
- vlerëson rilindësit iluministë: Naum Veqilharxhi, Pasko Vasa, Jani Vreto, Hoxha Tahsin; Naim e Sami Frashëri, Zef Jubani;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar prezantimin e temës së dhënë;
- organizon dhe prezanton faktet, argumentet, gjetjet, përfundimet e nxjerra mbështetur në burime.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Iluminizëm.
- Rilindje Europiane.
- Rilindje Kombëtare Shqiptare.
- Ndërgjegje kombëtare.
- Elite intelektuale.
- Lëvizje mbarëkombëtare.

Partnerët: Anëtarë të komunitetit që lëvrojnë në fushën e arteve dhe letërsisë.

Burimet kryesore të informacionit: Teksti, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi 3, materiale nga interneti, vepra të shkruara nga rilindasit tanë.

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- Përzgjedhja e temës, diskutimi
- Hulumtimi mbi temën
- Mbledhja e të dhënave
- Analiza e të dhënave
- Prezantimi i të dhënave
- Diskutim dhe Reflektim

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Diskutimi i temës së projektit dhe përcaktimi i tematikave të veçanta dhe krijimi i grupeve të punës
- Bisedë me studiues të letërsisë
- Hulumtim mbi dokumentet historike dhe letrare
- Hulumtim në internet dhe përgatitja e draftit final
- Përgatitja e informacionit për prezantim
- Prezantimi i projektit
- **Planifikimi i veprimtarive dhe produkteve sipas temave të projektit**


Tematika e orëve të projektit	Veprimtaritë kryesore të nxënësve sipas grupeve	Produkti i grupit/ve të punës
Diskutimi i temës së projektit dhe përcaktimi i tematikave të veçanta dhe krijimi i grupeve të punës	Shqyrtimi i propozimeve dhe përcaktimi i temës dhe çështjeve të projektit në bashkëpunim me nxënësit.	Tema dhe çështjet e projektit të mirëkuptuara dhe të pranuar nga gjithë grupet.
	Pyetje, përgjigje dhe sugjerime të nxënësve rreth temës dhe çështjeve që mund të përmbajë projekti.	
	Cilat janë rolet e secilit grup? Ndarja e detyrave në grupe. Dakordësia në grup. Kuptimi dhe	Organizimi i grupit, mirëkuptimi dhe kohezioni brenda grupit

	pranimi i rolit brenda grupit. Përcaktimi i qartë i detyrave për secilin grup dhe nxënës.	
Bisedë me studiues të letërsisë apo të historisë në lidhje me historinë dhe letërsinë e periudhës së Rilindjes.	Hulumtimi paraprak i materialeve të botuara nga studiuesi i ftuar për periudhën e Rilindjes dhe figurat në fokus të projektit Parashtrim paraprak i pyetjeve në grup bazuar në materialin e studiuar. Përgatitja e pyetjeve rreth tematikës së bisedës me studiuesin e historisë/letërsisë në lidhje me historinë dhe letërsinë e periudhës së Rilindjes Diskutim gjatë dhe në përfundim të bisedës me studiuesin e ftuar.	Përmbledhje e strukturuar e informacionit, ideve, vlerësimeve të përzgjedhura nga biseda dhe pyetjet e diskutimet e bëra.
Hulumtime mbi dokumentet historike, letrare dhe figurat më të rëndësishme të Rilindjes sonë Kombëtare.	Përzgjedhja nga nxënësit i figurave kryesore dhe përcaktimi i dy prej tyre për çdo grup, si fokus i projektit <i>(Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Jani Vreto, Hoxhë Tahsini, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Zef Jubani, etj)</i> Kërkimi, përzgjedhja, dhe shqyrtimi i dokumenteve historike dhe letrare në lidhje me historinë dhe letërsinë e periudhës së Rilindjes.	Përmbledhje e burimeve të shqyrtuara, ideve dhe vlerësimeve të përzgjedhura prej tyre, si pjesë e bibliografisë së projektit dhe referencat në hartimin dhe prezantimin e tij.
Hulumtim në internet për përzgjedhjen e dokumenteve për draftimin e projektit.	Ndarja e detyrave brenda grupit për shfrytëzimin e burimeve elektronike. Përdorimi i burimeve elektronike dhe vlerësimi kritik i përmbajtjes së përzgjedhur. Shqyrtimi i burimeve, ideve, vlerësimeve e qëndrimeve të autorëve të	Përmbledhje informacioni, idesh dhe qëndrimesh vlerësuese për dy figurat e përzgjedhura nga periudha e Rilindjes.

	ndryshëm për figurat e marra në studim. Realizimi i detyrës së dhënë individualisht dhe me mbështetjen e anëtarëve të tjerë të grupit	Bibliografi e burimeve të përdorura.
Përgatitja e informacionit për prezantim	Parashtrimi i detyrave të kryera nga secili nxënës sipas rolit në grup në formatin e prezantimit. Diskutim dhe reflektim për draft prezantimin e përgatitur. Parashtrim i argumentuar, sintetik dhe tërheqës i produktit në formatin e prezantimit.	Përgatitja e draft produktit të projektit në formatin e prezantimit.
Prezantimi i projektit në një nga formatet e përzgjedhura nga secili grup.	Përgatitja dhe strukturimi i produktit final të projektit për kontributin e figurave historike të përzgjedhura në Rilindjen Kombëtare. Përgjigje pyetjeve të bëra nga audienca dhe qëndrimi i grupit ndaj vlerësimeve dhe sugjerimeve të bëra.	Prezantimi i produktit final të projektit mbi kontributin e figurave të Rilindjes sonë Kombëtare. Ekspozitë me: dokumente; material në PPT; album; poster; video.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Nxënësit do të organizojnë një ekspozitë ku do të prezantojnë: video, dokumentarë, materiale në PPT, album, poster, para komunitetit të shkollës, duke ftuar prindërit, mësuesit dhe shokët e tyre të marrin pjesë. Nëpërmjet punimeve të projektit të prezantuara në ekspozitë nxënësit do të demonstrojnë njohuri/ shprehje/aftësi e qëndrime për shtrirjen kohore dhe gjeografike, periodizimin, idetë, synimet, përmbajtjen dhe kontributin e Rilindjes Shqiptare në formësimin



dhe konsolidimin e ndërgjegjes kombëtare. Ndikimi i Iluminizmit European te Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kontributi i figurave më të rëndësishme të Rilindjes sonë Kombëtare ku do të veçohen: *Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Jani Vreto, Hoxhë Tahsini, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Zef Jubani.*

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer dhe përdorimi i burimeve mbi kontributin e Rilindjes Shqiptare në formësimin dhe konsolidimin e ndërgjegjes kombëtare.
- ***Kuptimi i koncepteve:*** Shpjegimi i saktë i koncepteve në lidhje me periudhën e Rilindjes Shqiptare.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.

Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: Konferencë “Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës”.

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 6 orë mësimore (të planifikuara 2 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa XI ose XII

Rezultatet e të nxënësit:

Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi:

- evidenton rrethanat historike dhe pozitën e trojeve shqiptare në fillim të shek. XX;
- analizon qëndrimet e Fuqive të Mëdha evropiane ndaj procesit të krijimit të shtetit të pavarur shqiptar dhe hapave të parë të tij;
- vë në dukje përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për konsolidimin e pozitës së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha;
- vlerëson politikën e jashtme të monarkisë shqiptare;
- evidenton pozitën e Shqipërisë dhe shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- analizon aleancat dhe rreshtimin ndërkombëtar të shtetit komunist shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore;
- hulumton mbi ndryshimet në politikën e jashtme të shtetit shqiptar, orientimin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndryshimet në sistemet e aleancave pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste.
- gjykon mbi tiparet, ngjarjet kryesore dhe politikat përcaktuese të pozicionit të Shqipërisë në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare drejt një izolimi progresiv deri në zbatimin e politikës “Te mbështetemi në forcat tona”.
- vlerëson politikën e hapjes së Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist dhe identifikon hapat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Konceptet kryesore:

- “Bashkim personal”,
- “Shqipëri e Madhe”,
- “pavarësi relative”,
- konjunkturë ndërkombëtare,
- mbështetje në forcat e veta.

Partnerët që do marrin pjesë në projekt – Studiues të historisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, prindër, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

Burimet kryesore të informacionit:

- Teksti mësimor Historia 11 ose 12,
- Materiale nga interneti interneti,
- materiale të shkruara në formë publikimesh apo artikujsh për këtë tematikë,
- materiale audio vizuale me karakter dokumentar apo artistik,
- biseda me specialistë të fushës.

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

Ora I: Përzgjedhja e temës së projektit. Diskutimi i temës së projektit, përcaktimi i tematikave të veçanta dhe krijimi i grupeve të punës. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.

Ora 2: Përgatitja e pyetjeve për intervistën me studiuesin e historisë dhe/ose marrëdhënieve ndërkombëtare/ Hulumtim mbi dokumentet historike dhe në internet.

Ora 3: Biseda me studiues të historisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Përpunimi i materialit të marrë nga kjo bisedë. Ide mbi organizimin e konferencës, mjedisi, kohëzgjatja, programi dhe produktet që do të prezantohen.

Ora 4: Kërkimi, përzgjedhja e burimeve, strukturimi, hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Hartimi i draft programit të konferencës.

Ora 5: Hartimi i draftit përfundimtar të projektit, diskutimi i tij dhe reflektime nga secili grup.


Ora 6: Prezantimi i projektit në konferencë. Vlerësimi i punës në grup dhe punës individuale të nxënësve. Reflektime.

Metodologjia që do të përdoret: Punë në grup, hulumtim, intervista, diskutim, analizë, paraqitje, debat dhe shkëmbim mendimesh.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit. Nxënësit ndahen në grupe, me qëllim realizimin e projektit, njihen me përmbajtjen e projektit, me burimet e informacionit, me metodën e punës dhe japin idetë e tyre në lidhje me historinë e shqiptarëve dhe inkuadrimit në Evropën e Bashkuar;

- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup. Marrin nga mësuesi sugjerime mbi shpërndarjen e punës brenda grupit dhe ndajnë detyra për secilin nxënës brenda grupit brenda grupit në lidhje me: çështjet me rrethanat historike të trojeve dhe popullsisë shqiptare në përfundim të procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe rreziqet me të cilat përballeshin ato; rolin e Fuqive të Mëdha evropiane kundrejt shtetit të ri shqiptar dhe diferencon qëndrimet në favor apo kundër duke analizuar përplasjet e interesave mes tyre; përpjekjeve të faktorit të brendshëm dhe konjunkturave ndërkombëtare të shprehura në Konferencën e Paqes në Paris në konsolidimin e pozitave dhe njohjes ndërkombëtare të Shqipërisë; konceptet “bashkim personal”, “Shqipëri e Madhe”, “pavarësi relative”, në kuadër të pozitës së shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore; ndryshimet në politikën e jashtme të shtetit shqiptar, orientimin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndryshimet në sistemet e aleancave pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste; tiparet, ngjarjet kryesore dhe politikat përcaktuese të pozicionit të Shqipërisë në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare drejt një izolimi progresiv deri në zbatimin e politikës “Te mbështetemi në forcat tona”; politikën e hapjes së Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist; hapat e Shqipërisë në procesin e integritimit evropian.
- Hartimi i pyetësorit/intervistës me studiues të historisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në lidhje me kriteret dhe hapat që duhet të përmbushë Shqipëria në procesin e integritimit evropian. Përpunimi i gjetjeve të nxjerra nga kjo bisedë.
- Hulumtim mbi dokumentet historike dhe materialeve të marra hulumtim në internet për përzgjedhjen e dokumenteve dhe strukturimin e tyre për draftimin e projektit. Mësuesi udhëzon nxënësit të raportojnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit në trajtën e një raporti paraprak, dhe u këshillohet të tregojnë një vëmendje të veçantë për origjinalitetin e punimit.
- Përgatitja e informacionit për prezantimin në konferencë. Parashtrimi i i argumentuar, sintetik dhe tërheqës i detyrave të kryera nga secili nxënës sipas rolit në grup në formatin e prezantimit të produktit të projektit “Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës”. Diskutim dhe reflektim për draft prezantimin e përgatitur. Përgatitja dhe strukturimi i produktit final të projektit.
- Prezantimi në një konferencë i produkteve të projektit “Shteti shqiptar, sa larg dhe afër Evropës”. në një nga format e përzgjedhura nga secili grup. Në këtë konferencë të organizuar nga nxënësit mund të marrin pjesë prindër, mësues, dhe nxënës nga klasa të ndryshme. Diskutim lidhur me përfundimet e arritura. Mësuesi lehtëson diskutimet ku



nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për trajtimin e temës së projektit. Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxënësit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose zgjidhje të mundshme për integrimin në .


Përshkrimi i produktit të projektit

- Nxënësit do të organizojnë një konferencë ku do të prezantojnë: dokumentarë, prezantime në poëerpoint, ekspozitë me fotografi, poster, ose ekspozitë virtuale, para komunitetit të shkollës, prindërve, mësuesve dhe shokëve të tyre. Nëpërmjet punimeve të projektit të prezantuara në konferencë nxënësit do të demonstrojnë njohuri/ shprehi/aftësi e qëndrime për zhvillimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë që nga themelimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët tona. Ai duhet të diferencojë fazat e ndryshme të zhvillimit të kësaj pozite me veçoritë dhe të përbashkëtat e tyre. Një theks i veçantë do t'u vihet raporteve të Shqipërisë me vendet evropiane dhe vendin e saj në këto raporte deri në aspiratën e sotme për integrim në Bashkimin Evropian.
- Prezantimi i projektit do të realizohet në formën e një konference e cila do të përmbajë: dokumentarë, prezantime në powerpoint, ekspozitë me fotografi, poster, ose ekspozitë virtuale. Pra, grupet do të përzgjedhin një nga format e prezantimit në konferencë.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer dhe përdorimi i burimeve mbi historinë e shtetit shqiptar zhvillimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë që nga themelimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në aspiratën e sotme për integrim në Bashkimin Evropian.
- ***Kuptimi i koncepteve:*** Shpjegimi i saktë i koncepteve në lidhje me me: çështjet me rrethanat historike të trojeve dhe popullsisë shqiptare në përfundim të procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe rreziqet me të cilat përballeshin ato; rolin e Fuqive të Mëdha evropiane kundrejt shtetit të ri shqiptar dhe diferencon qëndrimet në favor apo kundër duke analizuar përplasjet e interesave mes tyre; përpjekjeve të faktorit të brendshëm dhe konjunkturave ndërkombëtare të shprehura në Konferencën e Paqes në Paris në konsolidimin e pozitave dhe njohjes ndërkombëtare të Shqipërisë; konceptet “bashkim personal”, “Shqipëri e Madhe”, “pavarësi relative”, në kuadër të pozitës së shtetit shqiptar



gjatë Luftës së Dytë Botërore; ndryshimet në politikën e jashtme të shtetit shqiptar, orientimin e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndryshimet në sistemet e aleancave pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste; tiparet, ngjarjet kryesore dhe politikat përcaktuese të pozicionit të Shqipërisë në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare drejt një izolimi progresiv deri në zbatimin e politikës “Te mbështetemi në forcat tona”; politikën e hapjes së Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist; hapat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë organizimit dhe prezantimit të projektit në konferencë.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese.	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme.
Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë	Nxënësit ndonjëherë	Nxënësit zakonisht	Nxënësit përdorin gjatë gjithë

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre.</i> <i>Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

